

Seancës Plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3488 Prot.

Tiranë, më 17 . 09 .2024

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, të propozuara nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi dhe Jorida Tabaku.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETËT

Gazment BARDHI

Jorida TABAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2023 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve Gazment Bardhi dhe Jorida Tabaku,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 69, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5, me përmbajtje si më poshtë:

4. Të gjithë tatimpaguesve, të cilët furnizojnë shërbime profesionale, që kanë parapaguar tatimin për periudhën 1 janar 2024 – 30 qershor 2024, sipas nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i shfuqizuar me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese, administrata tatimore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i kalon shumat e paguara për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesit. Pas kësaj, me kërkesë me shkrim, të tatimpaguesit, shuma e mbetur, nëse ka, rimbursohet automatikisht në llogarinë e tatimpaguesit ose kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

5. Të gjithë tatimpaguesve, të cilët furnizojnë shërbime profesionale, që janë ngarkuar me detyrime tatimore të papaguara për periudhën 1 janar 2024 – 30 qershor 2024, sipas nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i shfuqizuar me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese, administrata tatimore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, fshin nga sistemi detyrimin tatimor së bashku me kamatëvonesat.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar, më ____, ____.2024

K R Y E T A R J A

Elisa SPIROPALI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2023 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në datën 30 mars 2023, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili, ndër të tjera, shfuqizoi ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ligji në vijim pësoi disa ndryshime me aktet normative nr. 2, datë 07.06.2024 dhe nr. 7, datë 14.12.2023. Në nenin 24, pika 2, të Ligjit parashikohet se të ardhurat neto të tatueshme (fitimi i tatueshëm) nga biznesi për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit tatohet me normat progresive si vijon: për bazën tatimore vjetore 0 – 14 000 000 lekë, norma tatimore është 15% dhe për bazën tatimore mbi 14 000 000 lekë, norma tatimore është 23%. Sipas nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, të Ligjit, lehtësitë dhe përjashtimet tatimore të parashikuara në ligjin nr. 8348/1998 vazhdojnë të zbatohen. Kështu për individët tregtarë, të vetëpunësuarit dhe entitetet, me të ardhura bruto deri në 14 milionë lekë në vit, norma e tatimit mbi të ardhurat 0%, do të aplikohet deri më 31 dhjetor 2029.

Megjithatë, në të njëjtën dispozitë ishte parashikuar që norma e tatimit mbi të ardhurat 0% nuk aplikohet për tatimpaguesit e përcaktuar në nëndarjet “ii” (të vetëpunësuarit) dhe “iii” (entitetet), të cilët furnizojnë shërbime profesionale, lista analitike e të cilëve do të përcaktohej me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi rregullues lidhur me këto shërbime profesionale. Praktikisht, për subjektet që furnizonin shërbime profesionale, duke filluar nga 1 janari 2024, do të ishin subjekt i normës së tatimit 15% për të nivelin e të ardhurave vjetore 14 milionë lekë. Përveç kundërshtimit në komisionet parlamentare dhe seancën plenare, në datën 28 shkurt 2024, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesës së Grupit Parlamentar të PD-së, iu bashkuan edhe kontabilistët, audituesit ligjorë në datën 28 mars 2024 dhe avokatët në datën 24 prill 2024.

Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim në seancat plenare publike të datave 18.06.2024 dhe 25.06.2024 pretendimet e palëve dhe provat e dorëzuara, dhe me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 vendosi: “2. Shfuqizimin e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën. 3. Shfuqizimin e nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.”. Në thelb, Gjykata ka arsyetuar se përmbajtja e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të Ligjit të Tatimeve, që përcakton një kalendar të ndryshëm për hyrjen në fuqi të detyrimit tatimor për të vetëpunësuarit që furnizojnë shërbime profesionale në krahasim me të vetëpunësuarit që kryejnë veprimtari të mirëfilltë tregtare, e gërshetuar me masën e normës së re tatimore

prej 15%, mungesën e një periudhe të përshtatshme njoftimi për subjektet mbi të cilat rëndon norma e re tatimore, pa ndonjë lloj forme përshkallëzimi dhe pa u dhënë mundësinë e duhur subjekteve të përshtateshin me masën e re të normës tatimore cënon parimin e proporcionalitetit në drejtim të domosdoshmërisë/ashpërsisë së mjetit të përzgjedhur nga ligjvënësi. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se mungesa e masave të përshtatshme kalimtare, cënon edhe parimin e sigurisë juridike. Në konkluzion, Gjykata ka vlerësuar se dispozita e sipërcituar cënon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimin e sigurisë juridike, të sanksionuara nga nenet 4 dhe 11 të Kushtetutës.

Megjithatë, nga koha e hyrjes në fuqi të Ligjit deri në dhënien e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se 6541 tatimpagues që furnizojnë shërbime profesionale kanë parapaguar tatimin për periudhën 1 janar 2024 deri më 30 qershor 2024 në vlerën 500 milionë lekë, ndërsa pjesa tjetër e tatimpaguesve rezulton të jetë ngarkuar me detyrime tatimore dhe për shkak të mospagesës të jenë akumuluar edhe kamatëvonesa. Në mbledhjen e datës 9 shtator 2024 dhe seancën plenare të datës 12 shtator 2024, ministri i Financave, Petrit Malaj ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për të kthyer shumat e paguara nga profesionistët e lirë. Pikërisht nisur nga kjo situatë, me qëllim adresimin e shqetësimit të 6541 profesionistëve të lirë që kanë parapaguar tatimin, por edhe të tjerëve që rezultojnë debitor për shkak të mospagesës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka ndërmarrë këtë nismë ligjore që synon të ofrojë një zgjidhje përfundimtare për tatimin e paguar mbi bazën e dispozitës së shfuqizuar (nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë), të Ligjit nr. 29/2023. Kjo zgjidhje ka marrë për bazë modelin që ofron neni 75, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është konsultuar me përfaqësues të profesionistëve të lirë.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me qëllim dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare lidhur me 6541 profesionistë të lirë, të cilët kanë parapaguar tatimin për periudhën 1 janar 2024 – 30 qershor 2024, në shumën 500 milionë lekë, por edhe për profesionistët e lirë që janë ngarkuar me detyrime tatimore dhe kamatëvonesa, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka përgatitur një projektligj që parashikon dy ndërhyrje në dispozitat kalimtare të Ligjit aktual nr. 29/2023. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve synohet që të përcaktohen rregullat se si do të trajtohen shumat e paguara nga profesionistët e lirë, si dhe detyrimet e papaguara dhe kamatëvonesat, të cilat janë akumuluar mbi nenin 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, e Ligjit nr. 29/2023, të shfuqizuar me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

Konkretisht, ndërhyrja e parë ka të bëjë me të gjithë tatimpaguesit që furnizojnë shërbime profesionale, të cilët kanë parapaguar tatimin për periudhën 1 janar 2024 – 30 qershor 2024, sipas bazës ligjore të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave rezulton se në këtë kategori janë 6541 tatimpagues që kanë paguar një shumë prej 500 milionë lekë. Duke marrë për bazë modelin e përcaktuar në nenin 75, të Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, është parashikuar që administrata tatimore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i kalon shumat e paguara për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi. Pas kësaj, me kërkesë me shkrim të tatimpaguesit, shumat e mbetur, nëse ka, rimburohet në llogarinë e tatimpaguesit ose kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit. Nëpërmjet këtij modeli synohet

që shumat e tatimit të parapaguar nga profesionistët e lirë të kompensohen me detyrime të tjera tatimore aktuale apo të ardhshme, ose të rimbursohen në llogarinë e tatimpaguesit, sipas vullnetit të këtij të fundit.

Ndërsa, ndërhyrja e dytë ka të bëjë me të gjithë tatimpaguesit që furnizojnë shërbime profesionale, të cilët janë ngarkuar me detyrime tatimore të papaguara për periudhën 1 janar 2024 – 30 qershor 2024, sipas bazës ligjore të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Ministria e Financave nuk ka ofruar të dhëna sa i përket numrit të tyre apo shumës totale të detyrimeve tatimore. Këtyre tatimpaguesve për shkak të mospagimit të detyrimeve iu janë akumuluar edhe kamatëvonesa. Në këto kushte, propozohet që administrate tatimore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të fshijë nga sistemi detyrimet tatimore së bashku me kamatëvonesat. Këto ndërhyrje përbëjnë një zgjidhje përfundimtare të problematikës që u krijua për shkak të aplikimit të tatimit 15% për profesionistët e lirë, duke filluar nga 1 janari 2024, i cili sic u shpjegua gjërësisht më lart u gjet nga Gjykata Kushtetuese në shkelje të neneve 4 dhe 11 të Kushtetutës, e për rrjedhojë u shfuqizua.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i dy deputeteve të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 2 dispozita.

Neni 1 parashikon shtimin e pikave 4 dhe 5, të nenit 69, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të cilat parashikojnë kthimin e tatimit të paguar për profesionistët e lirë, ndërsa për ata që akoma nuk e kanë paguar tatimin, fshirjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesat.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje neni 83, pika 4 të Kushtetutës.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, të cilat do të përlllogariten pasi të merret mendimi i Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenin 82, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë.

DEPUTETËT

Gazment BARDHI

Jorida TABAKU